| | |
|---|---|
| **Emri i projektit:** | Shërbimet me bazë në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara. |
| **Kohëzgjatja:** | 01.05.2021 – 31.08.2021 |
| **Shtrirja gjeografike:** | Ferizaj |
| **Buxheti total i grantit (EUR):** | 5.500.00€ |
| **Objektivat:** | Përmirësimi i mirëqenies fizike dhe mendore të fëmijëve me aftësi të kufizuara<br>Sigurimi i mirëqenies emocionale dhe sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara<br>Informimi dhe këshillimi i familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara<br>Ndërgjegjësimi i komunitetit për të mbështetur gjithëpërfshirjen<br>Fuqizimi i Grupit Avokues të Prindërve. |
| **Grupet e synuara:** | Grupet e synuara janë fëmijë me aftësi të kufizuar (djem dhe vajza) të grup-moshës 0- 18 vjeç dhe familjet e tyre. Gjithsej 20 fëmijë do të përfitojnë nga shërbimet e integruara si dhe minimum 20 prindërit/kujdestar të fëmijëve do të përfitojnë nga ky program. |
| **Përmbledhje e grantit:** | Projekti fokusohet në ofrimin e shërbimeve me cilësi të lartë, shërbime profesionale, efikase dhe relevante për fëmijët me aftësi të kufizara dhe familjet e tyre si dhe mbështetje psiko-edukative për prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe fuqizimin e tyre per te avokuar per te drejtat e fëmijëve të tyre.<br>Shërbimet për fëmijët do të ofrohen në përputhje me nevojat e vlerësuara dhe sipas planeve individuale, informim dhe këshillim për prindërit për të lehtësuar zhvillimindhe mbështetur fëmijët e tyre në shtëpi, fuqizim kapacitetesh të punonjësve të shkollave, shërbime psiko-sociale, ndërgjegjësim të komunitetit, etj.<br>Projekti synon ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, duke kontribuar kështu ne integrimin e tyre në komunitet dhe aftësimin për shkollim dhe jetë të pavarur.<br>Projekti poashtu synon fuqizimin e kapaciteteve të prindërve për përkujdesje ndaj fëmijëve të tyre dhe krijimin e rrjeteve përkrahëse të prindërve duke kontribuar kështu në fuqizimin e tyre per te avokuar per te drejtat e fëmijëve të tyre |
| **Donatori:** | Komuna e Ferizajt – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale |